# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**www.qpz.gov.al**

**Nr.151 6 nëntor 2009**


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.956, datë 21.9.2009 | Për lejimin e kalimit tranzit të pesë autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë..... | 6831 |
| Vendim i KM nr.957, datë 21.9.2009 | Për lejimin e kalimit tranzit të disa autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë..... | 6831 |
| Vendim i KM nr.958, datë 6.5.2009 | Për miratimin e kategorive të licencave dhe të procedurave të aplikimit për licencë, të personave, fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari në sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura..... | 6832 |
| Vendim i KM nr.959, datë 11.6.2009 | Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Spanjës, për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore..... | 6834 |
| Vendim i KM nr.961, datë 18.9.2009 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i segmentit rrugor Fushë-Krujë-Milot..... | 6840 |
| Vendim i KM nr.963, datë 2.10.2009 | Për një shtesë në vendimin nr.486, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave "Për ndërprerjen e veprimtarisë së përpunimit të anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, në portet e durrësit dhe të Shëngjinit", të ndryshuar..... | 6855 |
| Vendim i KM nr.964, datë 2.10.2009 | Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë ..... | 6855 |
| Vendim i KM nr.969, datë 30.9.2009 | Për përcaktimin e kritereve për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, nga mikrondërmarrjet..... | 6856 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.970, datë 30.9.2009 | Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Ministrisë së Financave, të një sipërfaqeje trualli në kthesën e Kamzës, Tiranë..... | 6857 |
| Vendim i KM nr.972, datë 30.9.2009 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kozarë të qarkut të Beratit..... | 6857 |
| Vendim i KM nr.973, datë 30.9.2009 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Picar të qarkut të Gjirokastrës ..... | 6859 |
| Vendim i KM nr.974, datë 30.9.2009 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetëtore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës ..... | 6860 |
| Vendim i KM nr.1089, datë 4.11.2009 | Për disa ndryshime në vendimin nr.984, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve dhe “Master i nivelit të parë“, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010” ..... | 6861 |

**VENDIM**
**Nr.956, datë 21.9.2009**

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË PESË AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 22 shtator 2009, të 5 (pesë) autokolonave ushtarake italiane dhe të personelit shoqërues, të përbëra si më poshtë vijon:
- Autokolona e parë, nga 20 (njëzet) automjete dhe 24 (njëzet e katër) trupa;
- Autokolona e dytë, nga 2 (dy) automjete, 5 (pesë) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 32 (tridhjetë e dy) trupa;
- Autokolona e katërt, nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 40 (dyzet trupa);
- Autokolona e pestë, nga 7 (shtatë) automjete dhe 14 (katërmbëdhjetë) trupa.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

3. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.957, datë 21.9.2009**

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit- Qafë-Thanë, në datën 24 shtator 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 68 (gjashtëdhjetë e tetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 25 shtator 2009, të 5 (pesë) autokolonave ushtarake italiane, të përbëra si më poshtë vijon:

-Autokolona e parë, nga 14 (katërmbëdhjetë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa;

- Autokolona e dytë, nga 13 (trembëdhjetë) automjete dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) trupa;
- Autokolona e katërt, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 45 (dyzet e pesë) trupa;
- Autokolona e pestë, nga 18 (tetëmbëdhjetë) automjete dhe 35 (tridhjetë e pesë) trupa.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 26 shtator 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 35 (tridhjetë e pesë) trupa.

4. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit- Qafë-Thanë, në datën 29 shtator 2009, të 6 (gjashtë) autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë, nga 11 (njëmbëdhjetë) automjete dhe 22 (njëzet e dy) trupa;
- Autokolona e dytë, nga 10 (dhjetë) automjete dhe 13 (trembëdhjetë) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 20 (njëzet) automjete dhe 40 (dyzet) trupa;
- Autokolona e katërt, nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 60 (gjashtëdhjetë) trupa;
- Autokolona e pestë, nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 38 (tridhjetë e tetë) trupa;
- Autokolona e gjashtë, nga 9 (nëntë) automjete dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) trupa.

5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datat 24 e 29 shtator 2009, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

6. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datat 25 e 26 shtator 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

7. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.958, datë 6.5.2009**

**PËR MIRATIMIN E KATEGORIVE TË LICENCAVE DHE TË PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR LICENCË, TË PERSONAVE, FIZIKË DHE JURIDIKË, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË SISTEMET E FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10081, datë 23.202009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kategorive të licencave për personat fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë apo do të ushtrojnë veprimtari në menaxhimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura si më poshtë vijon:

a) Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria B për përpunimin e ujit për konsum publik

c) Kategoria C për largimin e ujërave të ndotura;

ç) Kategoria D për përpunimin e ujërave të ndotura.

2. Personat fizikë apo juridikë, për t'u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura duhet të dorëzojnë, pranë ERRU-së, dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën me shkrim për aplikim për licencë, sipas formës së kërkuar nga ERRU-ja;

b) Dokumentin e regjistrimit ligjor të operatorit, si person fizik apo juridik, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

c) Autorizimin nga pronari për drejtuesin ligjor, i cili jep të drejtën për të kryer të gjitha veprimtaritë për aplikimin dhe përdorimin e licencës përkatëse;

ç) Dokumentin e regjistrimit në organet tatimore të zonës administrative, ku kërkohet të kryhet shërbimi;

d) Lejen higjieno-sanitare nga Inspektori Sanitar Shtetëror i zonës administrative, ku kërkohet të kryhet shërbimi;

dh) CV-në e drejtuesit ligjor dhe teknik;

e) Lejen e mjedisit, kur kërkohet licencë për përpunimin e ujërave të ndotura;

ë) Dokumentet e kualifikimit të drejtuesit teknik, si më poshtë vijon:

i) Për sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura, drejtuesi teknik duhet të ketë diplomë universitare, në degët inxhinieri hidroteknike, ndërtim, inxhinieri elektrike, mekanike, mjedis apo disiplina të ngjashme, si dhe një përvojë pune mbi 5 vjet në këtë sektor;

ii) Në rastet kur operatori do të ushtrojë veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, ai duhet të ketë edhe një drejtues teknik të kualifikuar, me diplomë universitare në degët inxhinieri hidroteknike, të mjedisit, inxhinieri elektrike a në disiplina të tjera, të ngjashme;

f) Dëshminë e penalitetit për drejtuesin, ligjor dhe teknik;

g) Deklaratën me shkrim të drejtuesit ligjor dhe atij teknik, ku të deklarojë me përgjegjësi zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të nxjerra nga ERRU-ja, të standardeve shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit e të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Procesi i sigurimit të dokumentacionit të mësipërm nga ERRU-ja zgjat jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e aplikimit për licencë nga subjekti përkatës.

3. Ngarkohet Komisioni Kombëtar i ERRU-së për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi nr.400, datë 19.8.1999 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.959, datë 11.6.2009**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR BASHKËPUNIM DHE ASISTENCË TË NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Spanjës, për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**MARRËVESHJE**
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SPANJËS LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN DHE ASISTENCËN RECIPROKE MBI ÇËSHTJET DOGANORE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Mbretërisë së Spanjës, këtej e tutje referuar si palët;

*duke konsideruar* se shkeljet e legjislacionit doganor janë të dëmshme për interesat ekonomike, fiskale dhe sociale për vendet e tyre respektive, si dhe për interesat legjitime të tregtisë;

*duke konsideruar* se trafiku i lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe mallrave të tjera të dëmshme përbën një rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

*duke konsideruar* rëndësinë e vlerësimit të saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të mbledhura nga importimi apo eksportimi i mallrave, si dhe zbatimin e duhur të dispozitave mbi ndalimin, kufizimin dhe kontrollin;

*të bindur* se përpjekjet për të parandaluar shkeljet kundër legjislacionit doganor dhe përpjekjet për të garantuar mbledhjen e saktë të detyrimeve dhe taksave të importit dhe eksportit mund të bëhen më efektive nëpërmjet kooperimit ndërmjet autoriteteve doganore;

*duke marrë* në konsideratë rekomandimet e Këshillit të Kooperimit Doganor mbi asistencën reciproke administrative, të 5 dhjetorit 1953;

*duke marrë* në konsideratë gjithashtu konventën e veçantë mbi drogat narkotike (Nju- Jork, 1961), konventën mbi substancat psikotrope (Vjenë, 1971) dhe konventën kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope (Vjenë, 1988),

ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1
**Përcaktime**

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) "Autoritet doganor" nënkupton:

- Në Republikën e Shqipërisë: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave;

- Në Mbretërinë e Spanjës: Ministria e Ekonomisë dhe e Financave pa paragjykim për kompetencat e ministrive të tjera.

b) “Legjislacion doganor” do të thotë çdo ligj apo dispozitë për t’u zbatuar nga autoritetet doganore në lidhje me importimin, eksportimin dhe tranzitimin e mallrave, dhe gjithashtu çdo procedurë apo regjim doganor, lidhur me detyrimet doganore dhe taksat, ose të masave të ndalimit, kufizimit apo kontrollit, duke përfshirë trafikun e paligjshëm të drogave dhe të mallrave të tjera.

c) “Shkelje” do të thotë çdo shkelje e legjislacionit doganor, si dhe çdo përpjekje për shkelje të këtij legjislacioni.

d) “Detyrimet doganore” do të thotë të gjitha detyrimet, taksat dhe kuotat që ushtrohen dhe grumbullohen nga autoritetet doganore.

e) “Person” do të thotë çdo person fizik apo juridik.

f) “Autoriteti kërkues” do të thotë autoriteti doganor, i cili bën një kërkesë për asistencë mbi çështjet doganore.

g) “Autoriteti i kërkuar” do të thotë autoriteti doganor, i cili merr një kërkesë për asistencë mbi çështjet doganore.

i) “Dërgesa nën kontroll” do të thotë teknika e lejimit të dërgesave të paligjshme, të cilat përmbajnë ose dyshohet se përmbajnë lëndë narkotike, substanca psikotrope ose substanca të përbëra prej tyre, ose lëndë sensitive, që kalojnë nëpërmjet ose brenda territorit të palëve, me dijeninë dhe nën vëzhgimin e autoriteteve kompetente, me qëllim lehtësimin e hetimeve.

Neni 2

**Fushëveprimi i Marrëveshjes**

1. Autoritetet doganore të palëve do t’i japin asistencë njëra-tjetrës sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, me synim lehtësimin e lëvizjes së ligjshme të mallrave, zbatimin e legjislacionit doganor dhe gjithashtu parandalimin, hetimin dhe luftimin e shkeljeve në fushat e sipërpërmendura.

2. Asistenca e ndërsjellë, brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, do të jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e shtetit të palës së kërkuar dhe brenda kompetencave dhe burimeve të mundshme të autoritetit doganor të kërkuar.

3. Përmbajtja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në asistencën e ndërsjellë lidhur me çështjet kriminale, të cilat do të jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e palëve dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga palët.

Neni 3

**Asistenca sipas kërkesës**

1. Sipas kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta furnizojë autoritetin kërkues me çfarëdolloj informacioni të dobishëm lidhur me:

a) zbatimin korrekt të legjislacionit doganor dhe ndryshime thelbësore në këtë legjislacion;

b) përcaktimin korrekt të detyrimeve doganore, veçanërisht ato informacione lidhur me përcaktimin e vlerës doganore, klasifikimin tarifor dhe origjinën e mallrave;

c) parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve.

2. Sipas kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do të mbajë, për aq sa ka mundësi, survejim special mbi:

a) persona të njohur nga autoriteti doganor kërkues që kanë kryer një shkelje ose dyshohen për shkelje të legjislacionit doganor;

b) mallra, në transport apo magazinim, njoftuar nga autoriteti kërkues doganor se mund të shkaktojnë një trafik të dyshuar të paligjshëm ndaj territorit të vet;

c) mjete transporti të njohura ose të dyshuara se janë përdorur për kryerjen e shkeljeve doganore;

d) vende të dyshuara nga autoriteti kërkues doganor si të përdorura për të kryer shkelje doganore ose të përdorura për kundërvajtje të legjislacionit doganor.

3. Autoritetet doganore, sipas kërkesës, do t’i japin njëra-tjetrës informacion i cili tregon nëse:

a) mallrat e importuara në territorin e një prej palëve kontraktuese janë eksportuar ligjërisht nga territori i palës tjetër kontraktuese;

b) mallrat e eksportuara nga territori i një prej palëve kontraktuese janë importuar ligjërisht në territorin e palës tjetër kontraktuese, duke specifikuar, nëse ka, llojin e procedurave doganore të aplikuara mbi këto mallra.

Neni 4

**Asistenca spontane**

Autoritetet doganore do të furnizojnë njëra-tjetrën me asistencë, pa kërkesë paraprake, nëse ato e konsiderojnë këtë gjë të nevojshme për zbatimin korrekt të legjislacionit doganor, veçanërisht kur ato kanë informacion lidhur me:

a) veprime të konsideruara kontradikte me legjislacionin doganor;

b) mjete ose metoda të reja të përdorura për ndërmarrjen e veprimeve të tilla;

c) mallra të njohura si subjekt veprimesh në kundërshtim me rregullat doganore mbi importet, eksportet, tranzitin apo të ndonjë procedure tjetër doganore, veçanërisht përsa i përket drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve të drogave.

Neni 5

**Dërgesë nën kontroll**

1. Duke marrë në konsideratë ligjet e veta kombëtare, rregullat dhe procedurat, të dyja autoritetet doganore, me marrëveshje të ndërsjellë, mund të aplikojnë metodën e dërgesës nën kontroll të drogave, substancave psikotrope dhe lëndëve sensitive, me qëllim identifikimin e personave të implikuar në trafikun ilegal të këtyre drogave, substancave dhe mallrave, dhe gjithashtu për konfiskimin e tyre.

2. Ngarkesat e paligjshme në lidhje me të cilat janë kryer dërgesat nën kontroll, mund të zbulohen dhe të lejohen për transport të brendshëm, duke e lënë të paprekur ose duke e hequr ngarkesën e paligjshme, pjesërisht ose plotësisht.

3. Vendimet lidhur me përdorimin e dërgesave nën kontroll duhet të merren mbi një bazë rast pas rasti.

Neni 6

**Informacion mbi trafikun e paligjshëm të lëndëve të ndjeshme (sensitive)**

Autoritetet doganore, me iniciativën e tyre apo sipas kërkesës dhe pa vonesë, duhet të furnizojnë njëra-tjetrën me gjithë informacionin e përshtatshëm mbi aktivitetet të cilat përbëjnë ose mund të përbëjnë një shkelje ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e një prej palëve në fushat e mëposhtme:

a) qarkullimit të armëve, municioneve, eksplozivëve dhe pajisjeve për eksplozivë;

b) lëvizjes së objekteve të artit dhe antikuarëve, të cilat përbëjnë vlerë të rëndësishme historike, kulturore ose arkeologjike për një nga palët;

c) qarkullimit të lëndëve helmuese, materialeve nukleare dhe radioaktive, si dhe të substancave të tjera të rrezikshme për ambientin dhe shëndetin publik;

d) qarkullimin e mallrave që u nënshtrohen detyrimeve apo taksave doganore të konsiderueshme.

Neni 7

**Forma dhe thelbi i kërkesës për asistencë**

1. Kërkesat në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim, shoqëruar nga ato dokumente që mund të konsiderohen të dobishme për ekzekutimin e kërkesave të tilla shkelje. Kur është e nevojshme, për shkak të emergjencës së situatës dhe në kushtet kur nuk ekziston mundësia e

dërgimit të tyre me faks, kërkesat gojore mund të jenë të pranueshme, por kjo kërkesë në mënyrë imediate duhet të konfirmohet nga një kërkesë me shkrim.

2. Kërkesat, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

a) Autoritetin kërkues;

b) Masa që kërkohet të merret;

c) Objekti dhe shkaqet për kërkesë;

d) Treguesit, sa më të saktë dhe të kujdesshëm të jetë e mundur, mbi personat fizikë dhe juridikë nën hetim, si dhe mjetet e transportit, nëse njihen;

f) Një përmbledhje të fakteve lidhur me çështjen, si dhe të hetimeve të kryera ndërkohë.

3. Kërkesa duhet të dërgohet në gjuhën zyrtare të autoritetit të kërkuar doganor ose në anglisht.

4. Nëse kërkesa nuk i përmbush detyrimet formale, korrektimi ose kompletimi i saj mund të kërkohet, por gjithsesi mund të bëhet kërkesë për marrjen e masave paraprake.

Neni 8

**Ekzekutimi i kërkesës**

1. Kërkesa për asistencë dhe hetimet do të kryhen dhe zbatohen në përputhje me ligjet dhe rregullat e palës së kërkuar.

2. Në mënyrë që t'i përgjigjet një kërkese për asistencë, autoriteti i kërkuar do të procedojë brenda kompetencave dhe burimeve të veta të mundshme, si të ishte duke proceduar për llogari të vet ose sikur kërkesa të ishte bërë nga autoritete të tjera ose të së njëjtës palë, duke dhënë informacionin që posedon ndërkohë, duke kryer hetimet e duhura ose duke marrë masat e duhura që hetimet të kryhen.

3. Nëse autoriteti doganor i kërkuar nuk është institucioni i duhur për t'iu përgjigjur kërkesës, ai duhet t'ia transmetojë këtë kërkesë institucionit të duhur dhe nëse kërkohet, duhet të informojë autoritetin doganor kërkues.

Neni 9

**Prania gjatë hetimeve e punonjësve të palës kërkuese**

1. Punonjës të autorizuar në mënyrën e duhur të njërës palë, në raste të veçanta, me aprovimin e palës së kërkuar, sipas kushteve të vendosura nga kjo e fundit dhe kushtëzuar nga legjislacioni i shtetit të palës së përmendur, mund të jenë prezent në hetimet e kryera në territorin e shtetit të autoritetit tjetër doganor. Hetimet do të kryhen nga punonjës të palës, në territorin e së cilës janë duke kryer hetimet dhe punonjësit e palës tjetër mund të mundësojnë dhe të marrin informacion nga këto hetime.

2. Kur, sipas situatave të paraqitura në këtë Marrëveshje, punonjësit e njërës palë do të jenë prezent në hetimet e zhvilluara në territorin e palës tjetër, ata në çdo kohë duhet të jenë të aftë të tregojnë identitetin dhe pozicionin e tyre zyrtar. Ata nuk duhet të mbajnë uniformë dhe as të kenë armë dhe duhet të jenë përgjegjës për çfarëdo shkelje të rregullave të palës në të cilën janë duke kryer hetimet.

3. Punonjësit e autorizuar të njërës nga palët, në raste të caktuara, me aprovimin e autoritetit doganor të përfshirë, sipas kushteve të vëna nga ky i fundit dhe kushtëzuar nga legjislacioni kombëtar apo ndërkombëtar në fuqi, mund të hipin në bordin e anijeve apo avionëve të palës tjetër, gjatë operacioneve reale dhe gjithashtu për trajnime apo ushtrime. Pala pronare e mjeteve nuk mban asnjë përgjegjësi për ndonjë dëmtim apo paragjykim që mund të pësojnë punonjësit e palës tjetër në bordin e këtyre mjeteve në kryerje të operacioneve të përmendura.

4. Duke marrë në konsideratë legjislacionin kombëtar të palëve dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku bëjnë pjesë palët, anijet dhe avionët, duke pasur në bord punonjësit e palës tjetër, mund të procedojnë në kapjen e anijeve që kanë kryer shkelje ndaj legjislacionit doganor në ujërat territoriale të palës kërkuese apo në detet e hapura.

Për t'i dhënë efekt dispozitave të këtij paragrafi, pala kërkuese duhet të ketë autorizimin legal të nevojshëm për të hipur në bord për inspektim apo, kur është e nevojshme, ta drejtojë në port anijen që ka kryer shkeljen, duke marrë parasysh koston që mund të lindë si pasojë e dëmtimeve apo reklamimeve. Fakti që aksioni do të kryhet nga një anije me pronar palën e kërkuar, duhet të deklarohet në kërkesën për autorizim.

Kur flamuri i anijes që ka kryer shkeljen është i palës kërkuese, do të merret si e mirëqenë se është lëshuar autorizimi i nevojshëm për arsye të ekzistencës së punonjësve të saj në bordin e anijes apo avionit të palës së kërkuar.

Neni 10
**Komunikimi i informacionit**

1. Sipas kushteve dhe brenda kufijve të caktuar në këtë Marrëveshje, dhe me kushtin që legjislacioni kombëtar ta lejojë, autoritetet doganore do t'i komunikojnë informacion njëri-tjetrit në formën e dokumenteve, kopjeve të noterizuara të dokumenteve, raporteve etj., që mund të jenë dispozicion i tyre.

2. Dokumentet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, me aprovim të palës së kërkuar, mund të zëvendësohen nga informacion i kompjuterizuar, prodhuar në çfarëdolloj forme për të njëjtin qëllim.

Neni 11
**Përdorimi i informacionit**

1. Informacioni i përftuar sipas Marrëveshjes në fjalë mund të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuara në Marrëveshjen në fjalë. Mund të përdoren brenda çdo shteti për qëllime të tjera, vetëm me aprovimin me shkrim paraprak të autoritetit doganor i cili ka dërguar informacionin dhe do të kushtëzohet nga kufizimet që mund të vendosë ky autoritet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të pengojnë përdorimin e informacionit në çfarëdo proces, administrativ apo penal, i cili është hapur për shkelje të legjislacionit doganor.

3. Autoritetet doganore në regjistrat e tyre të evidencave, raportet dhe dëshmitë, si dhe në procedimet e çuara në gjykatë, mund të përdorin si fakte informacionin e marrë dhe dokumentet e përftuara në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

4. Përdorimi i këtij informacioni si fakt në gjykatë dhe pesha që do t'i jepet këtij, do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve.

Neni 12
**Konfidencialiteti i informacionit**

1. Çdo informacion i komunikuar në çfarëdolloj forme në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të jetë i një natyre konfidenciale. Do të mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe do të gëzojë mbrojtjen që i ofrohet këtij informacioni sipas ligjeve të palës që e merr atë.

2. Të dhënat personale nuk do të transmetohen kur ka shkaqe të arsyeshme që të bëjnë të besosh se transmetimi ose përdorimi i të dhënave të transferuara do të jetë në kundërshtim me parimet ligjore bazë të njërës prej palëve dhe në veçanti, nëse personi që ka të bëjë me këtë, mund të vuajë një diskriminim të të drejtave themelore të njeriut. Sipas kërkesës, pala marrëse do të informojë palën dërguese mbi mënyrën e përdorimit të informacionit të marrë dhe mbi rezultatet e arritura.

3. Të dhënat personale mund të transmetohen vetëm tek autoritetet doganore dhe në rast nevoje, për qëllime procedurale, te prokuroria apo autoritetet gjyqësore. Persona apo autoritete të tjera mund të marrin një informacion të tillë vetëm sipas një autorizimi paraprak të autoritetit dërgues.

Neni 13
**Ekspertët dhe dëshmitarët**

Një punonjës i autoritetit të kërkuar mund të autorizohet për t'u paraqitur, brenda kufijve të autorizimit të dhënë, si ekspert apo dëshmitar, në një proces penal apo administrativ lidhur me çështjet që mbulohen nga kjo Marrëveshje nën juridiksionin e shtetit tjetër dhe të prodhojë produkte të tilla, dokumente dhe kopje të noterizuara, sipas nevojës së procesit. Kërkesa për një paraqitje duhet të identifikojë në mënyrë specifike se mbi çfarë çështjeje dhe në çfarë pozicioni, titulli apo kualifikimi do të pyetet ky punonjës.

Neni 14
**Përjashtime dhe detyrimi për të dhënë asistencë**

1. Në rastet kur autoriteti i kërkuar është i mendimit se përgjigja ndaj një kërkese mund të bjerë ndesh me sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera themelore të shtetit të vet, ose mund të përfshijë shkelje të sekreteve profesionale, komerciale apo industriale, ky autoritet mund të refuzojë dhënien e asistencës së kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje, ta japë atë pjesërisht ose mund ta përmbushë atë sipas respektimit të disa kushteve ose kufizimeve.

2. Kur autoriteti kërkues bën një kërkesë për asistencë, i cili vetë nuk do të mund ta përmbushte nëse i kërkohej diçka e tillë nga autoriteti tjetër doganor, kjo gjë duhet të theksohet në kërkesë. Në këtë rast varet nga autoriteti i kërkuar vendimi nëse do t'i përgjigjet një kërkese të tillë.

3. Nëse asistenca pezullohet apo mohohet, autoriteti kërkues duhet të njoftohet pa vonesë me shkrim lidhur me këtë vendim dhe mbi shkaqet që çuan aty.

Neni 15
**Shpenzimet mbi asistencën**

1. Autoritetet doganore do të heqin dorë nga çdo kërkesë ndaj njëri-tjetrit për rimbursimin e shpenzimeve të dala gjatë vënies në zbatim të Marrëveshjes në fjalë, me përjashtim të shpenzimeve lidhur me ekspertët dhe dëshmitarët, si dhe shpenzimet për përkthyesit që nuk janë punonjës shtetërorë.

2. Kur shpenzime të konsiderueshme apo shumë të mëdha do të ose mund të kërkohen për ekzekutimin e kërkesës, palët duhet të konsultohen të vendosin afatet dhe kushtet nën të cilat kërkesa do të ekzekutohet, po ashtu dhe mënyrën sesi këto shpenzime do të dalin.

Neni 16
**Zbatimi i Marrëveshjes**

1. Bashkëpunimi dhe asistenca e mundësuar në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do t'i ngarkohet direkt autoriteteve doganore. Ato do të rakordojnë reciprokisht mbi rregullimet e hollësishme për këtë qëllim.

2. Të dyja autoritetet doganore mund të organizojnë kontakte direkte ndërmjet shërbimeve të tyre të ushtrimit të ligjit, investigimit dhe nëse është e nevojshme, mes departamenteve të tjera me synimin e lehtësimit të mjeteve të shkëmbimit të informacionit mbi parandalimin, investigimin dhe goditjen e kundërvajtjeve të ligjeve dhe të rregullave të doganës. Do të shkëmbehet një listë e punonjësve të caktuar me këtë punë dhe kjo listë do të rifreskohet herë pas here nga autoritetet doganore.

3. Autoritetet doganore mund të bien dakord për takime me synim rishikimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17
**Zbatimi territorial**

Kjo Marrëveshje do të jetë e zbatueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe në territorin doganor të Mbretërisë së Spanjës.

Neni 18
**Hyrja në fuqi dhe përfundimi**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e trembëdhjetë që nga data e njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, që komunikon se procedurat respektive të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë plotësuar nga palët.

2. Kjo Marrëveshje është përcaktuar të jetë e pakufizuar në kohë dhe do të qëndrojë në fuqi edhe gjashtë muaj pas datës së një njoftimi me shkrim nëpërmjet kanalesh diplomatike të njërës prej palëve mbi synimin e vet për ta përfunduar këtë Marrëveshje.

E nënshkruar në Tiranë, më 20 maj 2009, në tre origjinale, në gjuhët shqip, spanjisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast divergjence për shkak të përkthimit, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

**VENDIM**
**Nr.961, datë 18.9.2009**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR FUSHË-KRUJË – MILOT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i segmentit rrugor Fushë-Krujë – Milot.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 254 116 (dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) $m^2$, tokë/arë, me vlerë 87 576 435 (tetëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë, për sipërfaqen 15 112 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) $m^2$, tokë/truall, me vlerë 10 647 900 (dhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 98 224 335 (nëntëdhjetë e tetë milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 2 405 910 (dy milionë e katërqind e pesë mijë e nëntëqind e dhjetë) lekë të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 98 224 335 (nëntëdhjetë e tetë milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

6. Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “Kufizim pronësie” (proces gjyqësor) dhe “Konflikt gjyqësor”, kompensimi për efekt shpronësimi të bëhet pasi të jetë marrë vendimi, i formës së prerë, nga gjykata dhe pasi të jenë bërë regjistrimet në zyrën përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

7. Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “Urdhër kufizimi”, kompensimi për efekt shpronësimi të bëhet pasi të ketë përfunduar procesi i saktësimit, nga zyra përkatëse e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe pas konfirmimit, që do të merret nga kjo zyrë.

8. Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, kompensimi për efekt shpronësimi të bëhet pasi të ketë përfunduar ky proces dhe pasi të jetë marrë konfirmimi nga zyra përkatëse e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

9. Pronarët e përfshirë në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

10. Shpronësimi të fillojë më 30.9.2009 dhe të përfundojë më 30.12.2009.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet përkatëse “Konflikt pronësie (proces gjyqësor)”, “Konflikt gjyqësor”, “Urdhër kufizimi” dhe “Proces regjistrimi”, në bazë të pikave 6, 7 e 8 të këtij vendimi dhe dokumentacionit të pronësisë, ndërsa për pronarët e konfirmuar likuidimi të bëhet në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS "F.KRUJË-MILOT"

Qarku: LEZHË
Fshati: Fushë-Milot

| Nr. | Pronari | | Nr. | Arë | | | Truall | | | Vlera | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri Atësia Mbiemri | ZK | Pas. | Sip. $m^2$ | Çmimi $m^2$ | Vlera lekë | Sip. $m^2$ | Çmimi $m^2$ | Vlera lekë | totale lekë | Shënime |
| 1 | ALTIN GJON BIBA | 1677 | 29/24 | | | | 779 | 878 | 683962 | 683962 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 2 | MARJAN GJON BIBA | 1677 | 29/13 | 438 | 381 | 166878 | | | | 166878 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 3 | PREN FRROK PALAJ | 1677 | 29/16 | 1748 | 381 | 665988 | | | | 665988 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 4 | SKENDER SHUAIP ANXHAKU | 1677 | 29/14 | 268 | 381 | 102108 | | | | 102108 | Konfirmuar nga ZRPP |
| | **TOTALI** | | | **2454** | | **934974** | **779** | | **683962** | **1618936** | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS "THUMANË-MILOT"

Qarku: LEZHË
Fshati: Fushë-Mamurras

| Nr. | Pronari | ZK | Nr. | Arë | | | Truall | | | Vlera totale lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri Atësia Mbiemri | | Pas. | Sip. m² | Çmimi m² | Vlera në lekë | Sip. m² | Çmimi m² | Vlera në lekë | | |
| 1 | AVNI RUSTEM PEPA | 1676 | 212/14/1 | 356 | 352 | 125312 | | | | 125312 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 2 | DILAVER MEXHIT GJOKA | 1676 | 212/53/1 | 2940 | 352 | 1034880 | | | | 1034880 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 3 | DILAVER MEXHIT GJOKA | 1676 | 212/53/1 | 542 | 352 | 190784 | | | | 190784 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 4 | DILAVER MEXHIT GJOKA | 1676 | 212/52/1 | 626 | 352 | 220352 | | | | 220352 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 5 | KOL BIB ZIRA | 1676 | 213/19/1 | 534 | 352 | 187968 | | | | 187968 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 6 | KOL BIB ZIRA | 1676 | 213/20/1 | 1109 | 352 | 390368 | | | | 390368 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 7 | PASHK BIB ZIRA | 1676 | 213/21/1 | 90 | 352 | 31680 | | | | 31680 | Proces regjistrimi |
| 8 | PASHK BIB ZIRA | 1676 | 213/22/1 | 2352 | 352 | 827904 | | | | 827904 | Proces regjistrimi |
| 9 | ASLLAN QAZIM MILLA | 1676 | 60/17 | 460 | 352 | 161920 | | | | 161920 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 10 | BESNIK ZIJA SULA | 1676 | 60/18 | 1250 | 352 | 440000 | | | | 440000 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 11 | ALEKSANDER MARK CACURRI | 1676 | 64/35 | 1384 | 352 | 487168 | | | | 487168 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 12 | GJOK NDUE PERSKURA | 1676 | 64/37 | 202 | 352 | 71104 | | | | 71104 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 13 | PRENG NDUE PERSKURA | 1676 | 64/11 | 408 | 352 | 143616 | | | | 143616 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 14 | GJOK NDUE PERSKURA | 1676 | 64/10 | 1045 | 352 | 367840 | | | | 367840 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 15 | PRENG GJERGJ LALAJ | 1676 | 67/27 | 193 | 352 | 67936 | | | | 67936 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 16 | HANKE SHAQIR PORJA | 1676 | 67/28 | 253 | 352 | 89056 | | | | 89056 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 17 | VIKTOR ZEF MILLOSHI | 1676 | 67/14 | 2510 | 352 | 883520 | | | | 883520 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 18 | NIK ENGJELL MARKU | 1676 | 67/26 | 284 | 352 | 99968 | | | | 99968 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 19 | SHKELQIM BAJRAM NELAJ | 1676 | 70/23 | 534 | 352 | 187968 | | | | 187968 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 20 | NDUE PASHK BIBA | 1676 | 70/27 | 199 | 352 | 70048 | | | | 70048 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 21 | NDUE PASHK BIBA | 1676 | 70/25 | 1820 | 352 | 640640 | | | | 640640 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 22 | ADEM BEQIR GOCI | 1676 | 71/8 | 218 | 352 | 76736 | | | | 76736 | Proces regjistrimi |
| 23 | KURT BEQIR GOCI | 1676 | 71/7 | 1320 | 352 | 464640 | | | | 464640 | Proces regjistrimi |
| 24 | RAMAZAN ALI GOCI | 1676 | 74/6 | 2490 | 352 | 876480 | | | | 876480 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 25 | SHPETIM ALI GOCI | 1676 | 74/11 | 1604 | 352 | 564608 | | | | 564608 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 26 | XHEVIT HIDER SALA | 1676 | 86/7 | 2067 | 352 | 727584 | | | | 727584 | Konfirmuar nga ZRPP |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 27 | XHAFERR BEQIR GOCI | 1676 | 71/14 | 1496 | 352 | 526592 | | | | 526592 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 28 | SADRI HIDER SALA | 1676 | 86/10 | 1301 | 352 | 457952 | | | | 457952 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 29 | SADRI HIDER SALA | 1676 | 86/8 | 750 | 352 | 264000 | | | | 264000 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 30 | SABRI BAKI SELA | 1676 | 87/4 | 1706 | 352 | 600512 | | | | 600512 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 31 | GJOK PAL JAKU | 1676 | 87/3 | 303 | 352 | 106656 | | | | 106656 | Proces regjistrimi |
| 32 | PRENG NDUE SHPANI | 1676 | 87/8 | 2018 | 352 | 710336 | | | | 710336 | Proces regjistrimi |
| 33 | PRENG NDUE SHPANI | 1676 | 87/6 | 1064 | 352 | 374528 | | | | 374528 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 34 | ISLAM ALI MAXHALAKU | 1676 | 87/7 | 114 | 352 | 40128 | | | | 40128 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 35 | ISLAM HASAN HASANI | 1676 | 92/4 | 218 | 352 | 76736 | | | | 76736 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 36 | BAFTJAR MAXHALAKU | 1676 | 92/3 | 1499 | 352 | 527648 | | | | 527648 | Proces regjistrimi |
| 37 | EDI LIRI XHEKA | 1676 | 92/16 | 4374 | 352 | 1539648 | | | | 1539648 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 38 | ZEF PREN BUÇA | 1676 | 92/2 | 483 | 352 | 170016 | | | | 170016 | Proces regjistrimi |
| 39 | KADRI MEHMET DEMA | 1676 | 108/9 | 437 | 352 | 153824 | | | | 153824 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 40 | SALI HAJDAR DEMA | 1676 | 108/8 | 944 | 352 | 332288 | | | | 332288 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 41 | ZENEL HASAN HASANI | 1676 | 108/7 | 872 | 352 | 306944 | | | | 306944 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 42 | HASAN ISLAM HASANI | 1676 | 108/23 | 1037 | 352 | 365024 | | | | 365024 | Proces regjistrimi |
| 43 | ISLAM HASAN HASANI | 1676 | 108/24 | 879 | 352 | 309408 | | | | 309408 | Proces regjistrimi |
| 44 | ALI IDRIZ HASANI | 1676 | 108/25 | 776 | 352 | 273152 | | | | 273152 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 45 | IDRIZ HASANI | 1676 | 108/26 | 324 | 352 | 114048 | | | | 114048 | Proces regjistrimi |
| 46 | REXHEP ISLAM HASANI | 1676 | 108/1 | 233 | 352 | 82016 | | | | 82016 | Proces regjistrimi |
| 47 | VESEL IDRIZ HASANI | 1676 | 108/2 | 111 | 352 | 39072 | | | | 39072 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 48 | IDRIZ HASANI | 1676 | 108/3 | 181 | 352 | 63712 | | | | 63712 | Proces regjistrimi |
| 49 | ALI IDRIZ HASANI | 1676 | 108/4 | 265 | 352 | 93280 | | | | 93280 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 50 | ISLAM HASAN HASANI | 1676 | 108/5 | 268 | 352 | 94336 | | | | 94336 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 51 | HASAN ISLAM HASANI | 1676 | 108/6 | 76 | 352 | 26752 | | | | 26752 | Proces regjistrimi |
| 52 | BAJRAM RAMAZAN DEMA | 1676 | 109/2 | 1955 | 352 | 688160 | | | | 688160 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 53 | GJON NIKOLL REÇI | 1676 | 106/6 | | | | 414 | 831 | 344034 | 344034 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 54 | ESAT HAJDAR DEMA | 1676 | 106/4 | 260 | 352 | 91520 | | | | 91520 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 55 | GJON NIKOLL REÇI | 1676 | 105/8 | | | | 2513 | 831 | 2088303 | 2088303 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 56 | TEF VELI GOCI | 1676 | 105/5 | 41 | 352 | 14432 | | | | 14432 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 57 | ALI VELI GOCI | 1676 | 105/4 | 103 | 352 | 36256 | | | | 36256 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 58 | MUHARREM ISUF LIKA | 1676 | 155/3 | 687 | 352 | 241824 | | | | 241824 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 59 | ALI HASAN POJANI | 1676 | 155/5 | 10 | 352 | 3520 | | | | 3520 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 60 | GJON BARDHOK BACUKU | 1676 | 155/6 | 553 | 352 | 194656 | | | | 194656 | Proces regjistrimi |
| 61 | LEK PAL BACUKU | 1676 | 155/7 | 423 | 352 | 148896 | | | | 148896 | Proces regjistrimi |
| 62 | LEK PAL BACUKU | 1676 | 155/8 | 280 | 352 | 98560 | 35 | 831 | 29085 | 127645 | Proces regjistrimi |
| 63 | GJON BARDHOK BACUKU | 1676 | 155/9 | 202 | 352 | 71104 | 163 | 831 | 135453 | 206557 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 64 | LEK PAL BACUKU | 1676 | 155/11 | 497 | 352 | 174944 | | | | 174944 | Proces regjistrimi |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 65 | GJON BARDHOK BACUKU | 1676 | 155/12 | 466 | 352 | 164032 | | | | 164032 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 66 | ASLAM XHEMALI ALIU | 1676 | 158/68 | 538 | 352 | 189376 | | | | 189376 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 67 | KUJTIM XHEMAL ALIU | 1676 | 158/45 | 2795 | 352 | 983840 | | | | 983840 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 68 | ISLAM HASAN HASANI | 1676 | 158/46 | 961 | 352 | 338272 | | | | 338272 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 69 | HASAN ISLAM HASANI | 1676 | 158/47 | 713 | 352 | 250976 | | | | 250976 | Proces regjistrimi |
| 70 | ZENEL HASAN HASANI | 1676 | 158/48 | 841 | 352 | 296032 | | | | 296032 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 71 | ALI IDRIZ HASANI | 1676 | 158/49 | 1003 | 352 | 353056 | | | | 353056 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 72 | IDRIZ ISLAM HASANI | 1676 | 158/50 | 775 | 352 | 272800 | | | | 272800 | Proces regjistrimi |
| 73 | VESEL IDRIZ HASANI | 1676 | 158/51 | 570 | 352 | 200640 | | | | 200640 | Proces regjistrimi |
| 74 | REXHEP ISLAM HASANI | 1676 | 158/52 | 3044 | 352 | 1071488 | | | | 1071488 | Proces regjistrimi |
| 75 | REXHEP ISLAM HASANI | 1676 | 158/54 | 758 | 352 | 266816 | | | | 266816 | Proces regjistrimi |
| 76 | VESEL IDRIZ HASANAJ | 1676 | 158/55 | 209 | 352 | 73568 | | | | 73568 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 77 | ZENEL HASAN HASANI | 1676 | 158/63 | 161 | 352 | 56672 | | | | 56672 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 78 | PETRIT DED STOJANI | 1676 | 158/64 | | | | 73 | 1510 | 110230 | 110230 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 79 | HAJDAR MET MAXHALAKU | 1676 | 201/1 | 49 | 352 | 17248 | | | | 17248 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 80 | B.P BAKIE ADEM FERA | 1676 | 200/1 | 3248 | 352 | 1143296 | 200 | 1510 | 302000 | 1445296 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 81 | HYSANI DYL BICI | 1676 | 200/3 | 279 | 352 | 98208 | | | | 98208 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 82 | ALFRED AQIF BASHA | 1676 | 202/2 | 1734 | 352 | 610368 | 18 | 831 | 14958 | 625326 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 83 | ISHE AQIF JAURI | 1676 | 204/15 | 587 | 352 | 206624 | | | | 206624 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 84 | AHMET GANI ZANI | 1676 | 157/13 | 188 | 352 | 66176 | | | | 66176 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 85 | HAMDI HAJDAR ZANI | 1676 | 157/11 | 45 | 352 | 15840 | | | | 15840 | Proces regjistrimi |
| 86 | HAMDI HAJDAR ZANI | 1676 | 157/12 | 2031 | 352 | 714912 | | | | 714912 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 87 | GANI LIMAN ZANI | 1676 | 157/14 | 3852 | 352 | 1355904 | | | | 1355904 | Proces regjistrimi |
| 88 | REXHEP GANI ZANI | 1676 | 157/15 | 2080 | 352 | 732160 | 200 | 831 | 166200 | 898360 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 89 | AHMET GANI ZANI | 1676 | 157/16 | 2322 | 352 | 817344 | 200 | 831 | 166200 | 983544 | Proces regjistrimi |
| 90 | GANI LIMAN ZANI | 1676 | 157/17 | 1792 | 352 | 630784 | 200 | 831 | 166200 | 796984 | Proces regjistrimi |
| 91 | RAMAZAN LIMAN ISMAKU | 1676 | 157/18 | 926 | 352 | 325952 | 200 | 831 | 166200 | 492152 | Proces regjistrimi |
| 92 | ISLAM XHEMAL ALIU | 1676 | 157/19 | 3126 | 352 | 1100352 | | | | 1100352 | Proces regjistrimi |
| 93 | ARTAN GJON BACUKU | 1676 | 156/7 | 274 | 352 | 96448 | | | | 96448 | Proces regjistrimi |
| 94 | PJETER MARK PERKEQI | 1676 | 208/7 | 866 | 352 | 304832 | | | | 304832 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 95 | MARK KOL PERKEQI | 1676 | 216/19 | 837 | 352 | 294624 | | | | 294624 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 96 | MARTIN MARK PERKEQI | 1676 | 216/20 | 427 | 352 | 150304 | | | | 150304 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 97 | ALEKSANDER PJETER PERKEQI | 1676 | 216/22 | 417 | 352 | 146784 | | | | 146784 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 98 | PRENG ZEF HANI | 1676 | 216/6 | 1878 | 352 | 661056 | | | | 661056 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 99 | ALFRED PJETER GJEGJAJ | 1676 | 216/16 | 1053 | 352 | 370656 | 924 | 831 | 767844 | 1138500 | Konfirmuar nga ZRPP |
| | **TOTALI** | | | **94375** | | **33220000** | **5140** | | **4456707** | **37676707** | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS "THUMANË-MILOT"

Qarku: LEZHË
Fshati: Gjorem

| Nr. | Pronari | ZK | Nr. | Arë | | | Truall | | | Vlera totale lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri Atësia Mbiemri | | Pas. | Sip. $m^2$ | Çmimi $m^2$ | Vlera në lekë | Sip. $m^2$ | Çmimi $m^2$ | Vlera në lekë | | |
| 1 | DILE LAZER GJONI | 1768 | 46/1/1 | 1387 | 357 | 495159 | | | | 495159 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 2 | DILE LAZER GJONI | 1768 | 46/1/1 | 305 | 357 | 108885 | | | | 108885 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 3 | KOL SIMON STOJANI | 1768 | 46/2/1 | 596 | 357 | 212772 | | | | 212772 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 4 | KOL SIMON STOJANI | 1768 | 46/2/1 | 117 | 357 | 41769 | | | | 41769 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 5 | KOL SIMON STOJANI | 1768 | 46/14/1 | 590 | 357 | 210630 | | | | 210630 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 6 | KOL SIMON STOJANI | 1768 | 46/14/1 | 121 | 357 | 43197 | | | | 43197 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 7 | ZEF PASHK LLESHI | 1768 | 46/15/2 | 639 | 357 | 228123 | | | | 228123 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 8 | PRENE KOL TARAZHI | 1768 | 46/15/1 | 155 | 357 | 55335 | | | | 55335 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 9 | MARK PJETER GJOKA | 1768 | 46/22/1 | 1299 | 357 | 463743 | | | | 463743 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 10 | MARK PJETER GJOKA | 1768 | 46/21/1 | 150 | 357 | 53550 | | | | 53550 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 11 | DRITAN FRAN BROZI | 1768 | 46/11/1 | 391 | 357 | 139587 | | | | 139587 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 12 | TONIN MARTIN PREKA | 1768 | 46/13/1 | 218 | 357 | 77826 | | | | 77826 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 13 | TONIN MARTIN PREKA | 1768 | 46/12/1 | 643 | 357 | 229551 | | | | 229551 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 14 | HYSEN ISUF ALLAMANI | 1768 | 46/6/2 | 376 | 357 | 134232 | | | | 134232 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 15 | NDUE GJERGJ GJONAJ | 1768 | 46/18/1 | 818 | 357 | 292026 | | | | 292026 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 16 | NDUE NIKOLL MENGA | 1768 | 46/17/1 | 159 | 357 | 56763 | | | | 56763 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 17 | TONIN PAL BRUKA | 1768 | 46/8/1 | 778 | 357 | 277746 | | | | 277746 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 18 | TONIN PAL BRUKA | 1768 | 46/8/1 | 139 | 357 | 49623 | | | | 49623 | Konfirmuar nga ZRPP |
| 19 | DILE LLESH MINGA | 1768 | 46/9/1 | 270 | 357 | 96390 | | | | 96390 | Konflikt Gjyqesor |
